

Mr. Isuf AHMETI

PASHKO VASA E ISMAIL QEMALI NË SIRI DHE LIBAN

Ardhja e shqiptarëve si nëpunës të administratës osmane në Siri daton që nga shekulli XVI, kur filluan të emërohen nga Porta e Lartë valinjtë edhe me prejardhje shqiptare për të qeverisur në Vilajetin e Sirisë. Ky fenomen filloi të rritet gradualisht në gjysmën e parë të shekullit XIX, përkatësisht në vitin 1831, me ardhjen dhe vendosjen e ushtrisë së shqiptarit Ibrahim Pasha, duke e çliruar Sirinë nga sundimi osman.¹

Siria ka një territor që në lindje kufizohet me Irakun, në veri me Turqinë, në perëndim me Detin Mesdhe dhe në jug me Libanin e Jordaninë. Pozita strategjike e saj në Lindje ka bërë që për një kohë të gjatë të jetë vendkalim tregtarësh e karvanësh, të ushtrive, shpërnguljeve dhe kolonizimeve. Me fjalë të tjera.

Gjatë administrimit osman në Siri (1518-1918) pushteti kishte qëndrim pozitiv ndaj pakicave etniko-fetare. Në fillim të shekullit XX e deri me pushtimin francez 1920 në Siri kanë ardhur edhe pakica të tjera, edhe shqiptarë.

Në këtë vend bazën kryesore të popullatës e përbëjnë sunitët (rreth 40 për qind), të cilët kanë pasur, e edhe sot e kanë deri-diku, forcën ekonomike-politike. Pjesën më të madhe (afro 60 për qind) e përbëjnë pakicat e ndryshme etniko-fetare si të krishterë, hebrenj, shiitë etj.

Sa u përket shqiptarëve, në krahasim me kombet e tjera, ata në Siri janë pakicë. Numri i tyre ende nuk mund të vlerësohet saktësisht, ngase ndryshon vazhdimisht. Shkaku kryesor i shpërnguljeve atje të shqiptarëve nga Shqipëria ndryshon nga ai i shqiptarëve të Kosovës dhe të Maqedonisë Perëndimore, ngase këta të dytët kanë ikur nga gjenocidi dhe dhuna serbe, e të parët të shtyrë nga tradicionalizmi fetar dhe për shkaqe

¹M. Mufaku, Prania e shqiptarëve në Siri dhe roli i tyre në jetën siriane, Prishtinë, 1977, f.32-33.

ekonomike. Shqiptarët nuk u shpërngulën vetëm në Siri. Ata zunë vend edhe në Turqi, në Evropën Perëndimore, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në vende të tjera të botës. Ku kanë shkuar shqiptarët kanë lënë vepra të mira. Secili kontribuoi në profesionin që kishte pasur në vendlindje: në bujqësi, në tregti, në ushtri, në qeverisje, në letërsi, në shkencë e në lëmenj të tjerë.

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX erdhën në Siri në funksione të ndryshme edhe ca figura të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, si Pashko Vasë Shkodrani, Ismail Qemal Vlora etj. I pari, Pashko Vasa, erdhi në Siri rreth vitit 1867 si nëpunës i lartë në Vilajetin e Halepit. Siç duket, në këtë vend mbeti deri në vitin 1870, sepse atë vit e shohim në Stamboll ku merr pjesë në aktivitete të ndryshme kombëtare. Qëndrimi apo largimi i Pashko Vasës në Halep kontribuoi në zhvillimin e ndjenjave të tij për vendlindjen e atdheun. Kështu, qëndrimi i tij në Halep ishte i frytshëm së paku për krijimtarinë e tij poetike nën atë “qiell kaq të ngrohtë”, siç thotë në një vjershë të tij. Siç dihet, e asaj kohe është përmbledhja e tij e poezive “Trëndafila dhe gjemba“, që e shkroi në italisht dhe e botoi në Stamboll në vitin 1873.²

Në këtë përmbledhje kemi disa vjersha që mbajnë vendin dhe datat kur janë shkruar. Prej tyre tri janë shkruar në Halep (*qytet në Siri*), që mbajnë emrin e këtij vendi, por këtu mund të ketë shkruar edhe vjersha të tjera. Në këtë përmbledhje vjershat e Halepit janë shkruar më 3, 6 e 11 shtator 1867. Ndonëse në këto vjersha duket se poeti e ka humbur plotësisht shpresën në jetë dhe pret vetëm pleqërinë e zezë, prapëseprapë në fund të njërës, të shkruar në Halep më 3 shtator, dëshmon qëndresën e tij:

Rreziku na shtyp,

Por, se gjithash, nuk na shtron për dhe.³

Siç duket, gjatë qëndrimit të tij në Halep Pashko Vasa nuk ishte i ndarë prej rrethit të atij arab. Ai e shfrytëzoi kohën e qëndrimit në këtë vend për të mësuar gjuhën arabe. Këtë e dëshmojnë shënimet e mëvonshme që tregojnë se Pashko Vasa e dinte arabishten “që e mësoi gjatë detyrës disavjeçare në Halep të Sirisë“.⁴

Patrioti i Rilindjes Kombëtare Pashko Vasa në vitin 1883 shkoi edhe në Liban në cilësinë e mytesarifit të Malit të Libanit. Prej Vilajetit të Bejrutit Mali i Libanit është ndarë më 1861 me një administratë të posaçme që e udhëhiqte një mytesarif i krishterë i emëruar drejtpërdrejt

² Vehbi Bala, Pashko Vasa, Tiranë, 1979, f. 66.

³ Po aty, f. 72.

⁴ Po aty, f. 171.

nga sulltani. Sipas këtij rregulli, mytesarifi emërohej për pesë vjet. Pashko Vasa erdhi në Liban dhe filloi ta ushtronte funksionin e vet më 18 qershor 1883. Atëherë mori më vete bashkëshorten, Katerina Bonatin, si dhe vajzën Roza me burrin e saj Kupelianin.⁵ Popullsia e Libanit, sipas një dokumenti arkivor, mori vesh se Pashko Vasa është i njohur këtu, është shqiptar i një fisi nga Mirdita. Ai zotëron italishten, frëngjishten, anglishten, greqishten, turqishten, e edhe arabishten, të cilën e mësoi gjatë detyrës disavjeçare në Halep. Shkruan ese letrare në gazeta, poema në italisht dhe libra në frëngjisht.⁶ Në të vërtetë, Pashko Vasa u prit aq ngrohtësisht me të arritur në Liban, sa që poetët e vendit, si Hanna bej al-Asaad, Gjirmanos al-Shimali etj. e lavdëruan atë me sa vjersha pa pritur fillimin e punës së tij.⁷

Në fillim të qëndrimit të tij, Pashko Vasa i rreket studimit të historisë së vendit dhe gjendjes së tij aktuale, në mënyrë që t'i shërbente këtij vendi sa më mirë. Për mandatin e parë të tij 1883-1888 historianët arabë kanë fjalë të mira. Sipas njërit, historia mban në mend këtë mandat të Pashko Vasës, i cili u dallua me “drejtësi“, me reforma, me krijimin e sigurisë, me qeverisje të mirë si dhe me ndërtime“.⁸

Në fillim të mandatit të tij të dytë puna ndryshoi për shkak të keqpërdorimeve të dhëndrit të tij, Kupelian efendiut, i cili shërbente si drejtor i seksionit politik për Punë të Jashtme. Kupeliani me një rreth të ngushtë formoi një shtet në shtet, i cili u hapi rrugë veprimeve të paligjshme si privilegjit, bakshishit etj. Si pasojë e kësaj gjendjeje të re kundër Pashko Vasës u zhvillua një fushatë në shtypin jashtë Libanit. Për ta mbrojtur veten ai vendosi të themelonte një gazetë në gjuhën arabe, e cila doli në vitin 1896 në Ba'abda, qendër e Malit të Libanit, me emrin “Lubnan“ (Liban), nën drejtimin e Ibrahim al-Asuad.⁹ Në të Pashko Vasa botoi disa artikuj redaksionalë për probleme ekonomike, shoqërore, kulturore dhe shëndetësore të popullit libanez.¹⁰

Mirëpo, në këtë mandat të dytë, dhëndri Kupelian vazhdoi me të madhe veprimtarinë e tij të paligjshme, çka e dëmtoi rëndë Pashko Vasën para opinionit publik. Në atë kohë Kupeliani u komprometua keq me shpërdorimin e detyrës. Puna shkoi deri aty sa të akuzohej edhe vjehri për mbrojtjen e tij. Atëherë, Pashko Vasa mbajti qëndrimin e prerë dhe e dëboi nga Bejruti dhëndrin me të dyja mbesat, që i donte aq shumë.

⁵ Po aty, f. 175.

⁶ N. Islami, Mytesarif i katërt në Liban, “Rilindja“ Prishtinë, 4. IX. 1975, f. 9.

⁷ Dr. Viliam, Al-Hazin, al-Shiir ve al-vatania fi Lubnan ve al-buldan al-arabija, Bejrut, f. 408 (*Poezia dhe patriotizmi në Liban dhe në vendet arabe*), Bejrut, f. 408.

⁸ Po aty.

⁹ V. Bala, Pashko Vasa, Tiranë, 1979, f. 176.

¹⁰ Po aty.

Thuhet se pas kësaj ngjarjeje Pashko u dëshpërua shumë dhe ra nga shëndeti. Vdiq më 29 gusht 1892 dhe u varros me nderime në vendin al-Hazmija të Bejrutit. Trupi i Pashko Vasës pushoi në këtë vend afro 90 vjet, deri në qershor të vitit 1978, kur qeveria libaneze u pajtua të barteshin eshtrat e tij në Shkodër, ku u varros me nderimet më të mëdha më 25 qershor të atij viti.¹¹

Marrë në përgjithësi, Pashko Vasa gjatë qëndrimit në Liban bëri shumë punë. Me interesimin e tij të drejtpërdrejtë u bënë disa ndërtime të mëdha, si: Salla ministrore në Pallatin Bejtuldin afër Bejrutit, sarajet qeveritare në Xhunje dhe ato të Zahilës, spitali më i madh i Bejrutit, themelet e pallatit presidencial në Ba'abda, 117 ura në vise malore, duke i lidhur ato me pjesët më të qytetëruara të vendit, rrugët Bejrut-Zahle dhe Bejrut-Brumaba, ndërtime këto që e bënë Libanin të quhej “Venediku i thatë”.¹²

Pashko Vasa u çmua shumë edhe për ngritjen e shkollave, sidomos në zonat më të lëna malore të vendit. Përfaqësues të opinionit publik të Libanit disa herë kanë shprehur mirënjohje për këto veprime të dobishme. Edhe kundërshtarët e tij politikë nuk mundën të mos shprehnin mendimin se “vendi ishte i favorizuar nga kujdesi mirëdashës i Qeveritarit të Përgjithshëm, shqiptarit Pashko Vasa”.¹³

Këto përshtypje të mira që la Pashko Vasa në mesin e libanezëve i gjejmë edhe në krijimtarinë e poetëve libanezë Tamir al-Mallat, Shakib Arslan, Ibrahim al-Asuad etj.¹⁴ Interesimi i këtillë i poetëve mund të lidhet me faktin se edhe vetë Pashko Vasa ishte poet. Do përmendur edhe interesimi i Pashko Vasës për themelimin e teatrit kombëtar libanez, duke shkruar vetë disa pjesë me vlerë edukative për fëmijët, të cilat u shfaqën në Bejrut. Fatkeqësisht, ne nuk i kemi në dorë këto pjesë.¹⁵

Nga ana tjetër, Libani nuk e pengonte fare Pashko Vasën që të vazhdonte aktivitetin e tij në kohën e Rilindjes Kombëtare. Këtë e vërtetojnë letërkëmbimet e tij me patriotët më të shquar të kohës dhe me njerëzit e tij të afërt, në një kohë kur në Stamboll dhe në kolonitë e tjera shqiptare kishte filluar puna për ngritjen e shoqërive kulturore dhe të shtypit shqiptar. Pashko Vasa është në kryesinë e nderit të shoqërisë “Drita” të Bukureshtit dhe atëherë botohet poema e tij e njohur “Mori Shqypni, e mjera shqypni!”. Ndërkohë, ai kishte korrespondencë me poetin Naim Frashëri. Më 1890 merr prej Naimit përmbledhjen poetike

¹¹ Po aty, f. 173-255.

¹² N. Islami, Lufta kundër kolerës, “Rilindja”, Prishtinë, 6.IX. 1975, f. 8.

¹³ G. Berthaut, H. Fares, Les mysteres du Liban sous Wassa Paschia et Kupelian, le Caire, 1891, f. 167.

¹⁴ M. Mufaku, Shqiptarët në botën arabe, Rilindja, Prishinë, 1990, f. 56.

¹⁵ V. Bala, Pashko Vasa, Tiranë, 1979, f. 179.

“Lulet e verësë“ dhe, i entuziazmuar nga patriotizmi i saj, u vu të përkthente frëngjisht disa vjersha të asaj përmbledhjeje.¹⁶

Mbi të gjitha këto, Pashko Vasa gjatë qëndrimit të tij në Liban shkroi dhe botoi veprat e tij më të vlefshme për gjuhën dhe letërsinë shqiptare. Kështu, hartoi veprën “Gramatikë shqipe“, përkatësisht “Gramatikë shqipe për t’u përdorur nga ata që dëshirojnë ta nxënë këtë gjuhë pa ndihmën e një mësuesi“. Kjo vepër, e hartuar në frëngjisht, u botua në Londër më 1887.¹⁷

Gjatë qëndrimit në Liban Vasa e shkroi në gjuhën frënge romanin me tematikë shqiptare “Bardha e Temalit“, i cili u botua në Paris në vitin 1890.¹⁸ Ky roman ka rëndësi historike ngase konsiderohet romani i parë i shkruar prej një autori shqiptar në përgjithësi.¹⁹ Nga ana tjetër, Pashko Vasa afirmoi shqiptarët në Liban, pasi u botua në gjuhën arabe vepra e tij e njohur “Shqypnia dhe shqiptarët“. Kjo vepër u botua në vazhdime në revistën mujore libaneze “al-Xhinan“, në përkthim në Nexhib al-Bustanit,²⁰ gjatë vitit 1884. Botimi arab i kësaj vepre ka rëndësi të dorës së parë, sepse u ofroi arabëve për herë të parë të dhëna të mira për historinë e popullit shqiptar.

Nga ana tjetër, Ismail Qemali shprehu një largpamësi për Sirinë në tërësi, duke kuptuar në thelb problematikën e këtij vendi:

Siria është vendi më i bukur dhe më i rëndësishëm i Turqisë në Azi dhe megjithëkëtë Damasku, që është kryeqendra e vilajetit, kishte shumë mungesa... Kishte qenë gabim të ndahej Siria në dy vilajete, në atë të Bejrutit me bregdetin dhe në atë të Damaskut me pjesën e brendshme. Kjo ndarje pati pasoja të këqija ekonomike dhe administrative duke i paralizuar punët në çdo fushë...²¹

Ismail Qemali pohon në kujtimet e tij se “kish shumë punë për të kryer në këtë vend shumë të bukur ku mjetet nuk mungojnë”. Mirëpo, ai nuk ishte i lirë për t’i zbatuar idetë e tij, ngase “duke qenë se këtu isha me cilësinë e zëvendësit, duhet të prisja urdhëratë e sulltanit nëse duhesha të shkoj në Bejrut pasi të emërtohesha guvernator për Damaskun ose nëse do të kryesoja të dy vilajetet e bashkuara, siç ishin më parë“.²²

¹⁶ N. Islami, Lufta kundër kolerës, “Rilindja“, Prishtinë, 6.IX. 1975, f. 9.

¹⁷ V. Bala, Pashko Vasa, Tiranë, 1979, f. 183-191.

¹⁸ Më gjerësisht për këtë roman shih në parathënien e Ymer Jakës në Pashko Vasa, Bardha e Temalit, Prishtinë, 1969.

¹⁹ Më gjerësisht: Rexhep Qosja, Teoria e romanit në praktikë (I), “Fjala“, Prishtinë, 1. XI. 1982, f. 5.

²⁰ Këtë përkthim e zbuloi për herë të parë Nehat Islami. Shih: Shqypnia dhe shqiptarët në arabishtë, “Rilindja“, Prishtinë, 18.06.1977.

²¹ I. Qemal Vlora, Kujtimet, Toronto, 1968, f. 142.

²² Po aty, f. 143-144.

Mirëpo, Ismail Qemali në Siri nuk qëndroi shumë sepse u ftua nga sulltani për t'u ngarkuar me një mision të rëndësishëm. Megjithatë, edhe pse në Siri qëndroi jo më shumë se një muaj, ai u largua me një keqardhje prej këtij vendi, sepse kishte dëshirë të zbatonte reforma radikale që do ta shpëtonin atë vend nga gjendja e mjerueshme në të cilën kishte rënë. Në fund të kujtimeve të tij për Sirinë, Ismail Qemali jep vlerësime aq serioze për këtë vend, sa që fitohet përshtypja se këto analiza janë të një patrioti përparimtar të Sirisë: “Siria duhet të jetë vendi më i pasur dhe i lulëzuar në Lindje për shkak të tokës së begatshme, lehtësisë së transportit dhe zgjuarsisë së banorëve. Por, për fat të keq, lënia pas dore nga ana e autoriteteve dhe shtypja e banorëve, si për mungesë të sigurisë botërore, si për trajtime të padrejta, kishin përfunduar me gjendje të mjerueshme të vendit. Fshatra të tëra ishin bërë pronë private e njerëzve me influencë dhe shumë fshatarë kishin qenë të shtrënguar nga taksat e shumta të shisnin tokën. Ish një detyrë e ngutshme për guvernatorin të ndreqte këto padrejtësi të shëmtuara...Nuk mu duk se do të kam shumë vështirësi të zbatoj ligjin, por thirrja ime në Stamboll më ndaloi që të vë në jetë mendimet dhe planin tim. Më vjen shumë keq, sepse puna ime do kish pasur për rrjedhojë në zhvillim të shënuar në bujqësinë e vendit”.²³

Është me rëndësi të përmendet këtu se qëndrimi i Ismail Qemalit ndaj Sirisë nuk ishte një gjë e rastit, që u paraqit aty për aty gjatë mandatit të tij njëmuajor si vali i Sirisë. Përkundrazi, kujtimet e tij flasin se ai nuk e shikonte Sirinë të ndarë, por e trajtonte si pjesë të një qenieje kombëtare të madhe. Lidhur me këtë është me mjaft interes të paraqitet qëndrimi i Ismail Qemalit ndaj botës arabe, sepse ai arriti të kuptonte shumë herët rëndësinë e bashkimit të vendeve arabe. Në kujtimet e tij ai parashikon mundësinë e krijimit të një shteti të ri të dobishëm“ nga vendet e Egjiptit, Tripolit, Sirisë, Mesopotamisë, Hixhazit, Arabisë dhe Jemenit, që rrethojnë Kanalin e Suezit dhe Gjirin e Persisë, popullsia e të cilave është e njëjtë lidhur me gjuhë, zakone e fe”.²⁴

Kjo figurë e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, Ismail Qemali, në fund të shekullit XIX shkoi në Liban dhe u gëzua pa masë kur u takua aty me Pashko Vasën. Në të vërtetë, Ismail Qemali arriti në Bejrut në janar të vitit 1892 në cilësinë e valiut për ta udhëhequr Vilajetin e Bejrutit që kishte atëherë një territor të madh, prej Latakjes në veri deri në qytetin Jafa në jug, që gjendet tani në Palestinë. Ndonëse I. Qemali qëndroi një kohë të shkurtër në krye të këtij vilajeti, Libani la një ndikim të dukshëm në shpirtin e tij, çka dëshmojnë kujtimet e tij.

²³ Po aty, f. 144-145.

²⁴ Po aty.

Rëndësia e këtij vendi, siç thotë I. Qemali në kujtimet e tij, si dhe klima e butë, e freskuan shpirtin e tij dhe e nxitën të punonte me zell për kryerjen e detyrës së ngarkuar. I. Qemali dashurohet me Libanin dhe kujdeset për interesat e tij më shumë sesa vetë libanezët. Ai dëshpërohet në fillim, sepse shumë nga familjet e para të vendit si Suksakët, Bustrosët e të tjerë qenë aq shumë të pa interesuar në çështje të qeverisë sa që për të pasur mbrojtjen e të huajve hynin në shërbimin e konsullatave të ndryshme me honorarë, pa rrogë. Ai u mundua të nxiste interesimin për çështjet e vendit dhe arriti t'i nxiste ata të bëheshin më aktivë për fatin e vendit të tyre si familje të pasura, e jo të pranonin atë që nuk është e përshtatshme për shkallën e tyre shoqërore.²⁵

Në qeverisjen e këtij vendi Ismail Qemali ndeshet me probleme të ndryshme, të cilat i zgjidhte aty për aty, në mënyrë që libanezët gëzonin sa më shumë liri. Një ditë, siç thotë ai në kujtimet e tij, iu paraqit drejtori i gazetës katolike arabe "al-Bashir" dhe iu ankua kundër sekretarit të përgjithshëm të Vilajetit që kishte detyrën e censurës, sepse kishte ngulur këmbë që të hiqej fjala arabe "Um Allah" (Nëna e Perëndisë) prej gazetës. Ky sekretar, Hasan efendiu, ishte shok i ngushtë i I. Qemalit. Hasani ngulte këmbë se një qeveri myslimane nuk mund të lejonte të shtypeshin fjalët "Nëna e Perëndisë", për ç'arsye I. Qemalit iu detyrua të përdorte tërë fuqinë e tij bindëse që t'ia mbushte mendjen se heqja e këtyre fjalëve do të thotë heqja dorë e katolikëve nga artikulli i parë më i rëndësishmi i besimit të tyre.²⁶

Ismail Qemali gjatë qëndrimit në krye të këtij vilajeti bëri një shëtitje në anë të ndryshme të vilajetit për t'u njohur me problemet e popullsisë. Ai gjeti kohë të vizitonte qytetin e vjetër Ba'albak, të pasur me monumente historike. Aty, beduinët²⁷ e vendosur në çadra dëgjojnë për ardhjen e tij dhe e ftojnë në një drekë, në mënyrë origjinale arabe. Në kujtimet e tij ai përshkruan hollësisht atë drekë interesante dhe pritjen që i organizuan beduinët, të cilët u gëzuan kur e panë atë në mesin e tyre duke u ulur në mënyrë modeste.²⁸

Në vjeshtë të vitit 1892 i erdhi Ismail Qemalit në Bejrut një telegram nga sultani që e thërriste menjëherë në Stamboll "për t'u ngarkuar me një mision të rëndësishëm". Populli i Bejrutit shfaqti hidhërimin e tij për largimin e I. Qemalit, por telegrami i gëzoi nga ana tjetër duke marrë me mend se fjalët e telegramit donin të thoshin se I. Qemali do të emërohej vezir i madh. Në shenjë mirënjohjeje, qyteti i Bejrutit ia dhuroi I. Qemalit

²⁵ Po aty, f. 139.

²⁶ Po aty, f. 140.

²⁷ Beduinët janë fshatarë që jetojnë nëpër fshatrat e shkretëtirës së Saharasë.

²⁸ I. Qemal Vlora, Kujtimet, Toronto, 1968, f. 144.

një album, kujtim që përmblihte të gjitha pamjet fotografike të vendeve të shënuara, i lidhur me fije ari me një smerald (gur të çmueshëm) në mes.²⁹

Krejt në fund mund të pohojmë se shqiptarët në botën arabe luajtën një rol të rëndësishëm edhe në prezantimin e kulturës shqiptare jo vetëm në Siri dhe Liban por në tërë botën arabe në tërësi. Kjo na bën të mburremi me vëllezërit dhe patriotët tanë, që jetuan dhe ende jetojnë në shtete të ndryshme. Përkundër faktit se jetuan të shkëputur nga trungu i vatrave të tyre shekullore, ata kanë arritur famë dhe autoritet të lartë.

Mr. sc. Isuf AHMETI

SUMMARY

PASHKO VASA AND ISMAIL QEMALI IN SYRIA AND LEBANON

Albanians arrival in Syria and Lebanon as administration officials dates since the 16th century, when walies of Albanian origin appointed by Sublime Porte started to govern Wilajet of Syria and Lebanon.

In the second part of 19th century in Syria and Lebanon also, came some Albanians, leading figures of National Renesance Movement, as Pashko Vasa-Shkodrani, Ismail Qemali Vlora, etc. Pashko Vasa came to Syria around 1867, as high official in Haleppo Wilajet where he remained until 1870. Vasa went to Lebanon in 1883, as mutasarrif (governor) of Mount Lebanon. He died on August 29, 1892 and was buried with great honours in al-Hasimija of Beirut. Pashko Vasa's body rested for 90 years in this country, until June 1978, when Lebanese government agreed the exhumation for handing his bones back to Shkodra, where the re-burial was performed with great honours on 25 June 1978.

Ismail Qemali arrived in Beirut on January 1892 as the walii – governer of Beirut Vilayet, which covered great territory at the time, from Lataqia in North to the town of Jafa in South. In autumn of the same year he received in Beirut a telegram from Sultan who called him back immediately to Istanbul “for taking the charge of an important mission”. Beirut people showed dismay because of Ismail Qemajli's departure, but the telegram was followed by joy on the other side, since he was appointed for the Grand Vizier (prime minister of Porte)

²⁹ Po aty, f. 145.